

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Personeli kryesor dhe personeli i shërbimit në detyrë (roje objekti) i shoqërive private të ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve, duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për këto shoqëri.

Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) per nje roje
1	Shpenzime per page baze	
2	Shtese mbi page per turn II	
3	Shtese mbi page per turn III	
4	Shtese mbi page per dite pushimi dhe festash	
5	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore	
6	Tarifa minimale per takse armembajtje, municion , mirembajtje armatimi etj	
7	Shpenzime per uniforme dhe veshembathje	
8	Shpenzime per nderlidhje	
9	Shpenzime te tjera (administrative, etj.)	
10	Fitimi	
	<b>Totali i shpenzimeve per nje roje/muaj</b>	

Skicimet, parametrat teknik etj:

-Numri i rojeve per vendroje me sherbim 24 ore (3 turne) eshte 4.7 roje per nje vendroje per 303 dite ( ose 10.1 muaj ).

**Shërbimi që kërkohet:** *Sherbim me Roje private ne ambientet e Spitalit Sarande, me adrese Rr. Onhezmi , L.3, me qellim ruajtjen e qetesise, renditt, sigurise se jetes se personelit gjate orarit zyrtar dhe parandalimin e cdo tentative ose veprimi qe ka per synim vjedhjen ose demtimin e pasurive te luajshme dhe te paluajshme.*

### **Shenim**

Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë ofertat e tyre duke patur parasysh kërkesat dhe fondin limit të përcaktuar në tabelën e dokumentave standarte të tenderit.

- Numri i rojeve për të realizuar shërbimin 4.7 (kater presje shtate ) roje me 1 vendroje me tre turne, në Drejtorine e Sherbimit Spitalor Sarandë.
- Rojet duhet të jenë të pajisur me armë.
- Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e sherbimit të ruajtjes, radio komunikimi.
- Rojet duhet të jenë të pajisur me uniformë, sipas legjislacionit në fuqi.

**Sqarim:** Në ofertë duhet të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet e përgjithshme, për uniformat (veshembathjen), armatim, ndërldhje (si radiomarrës etj), shpenzimet për pagën

e rojeve, shtesat mbi pagën për turnin e dyta (ora 19.<sup>00</sup> - 22<sup>00</sup>), shtesat mbi pagën për turnin e tretë (ora 22.<sup>00</sup> - 06<sup>00</sup>), shtesat mbi pagën për ditët e pushimeve dhe ditët e festave, sigurimet shoqerore dhe shëndetësore si dhe të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni në fuqi, për 4.7 (kater presje shtate ) roje me 1 vendroje me tre turne , në Drejtorine e Sherbimit Spitalor Sarandë.

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

*Kerkohet sherbim me roje private ne ambientet e Spitalit Sarande , me adrese Rr. ONHEZMI , L.3 , me qellim ruajtjen e qetesise, rendit, sigurise se jetes se personelit gjate orarit zyrtar dhe pas tij si ne ditet e punes te pushimit dhe festat zyrtare dhe parandalimin e cdo tentative ose veprimi qe ka per synim vjedhjen ose demtimin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme ne teritorin dhe ambientet e spitalit.*

Sherbimi do te kryhet per 24 ore ne dite per te gjitha ditet kalendarike duke perfshire te shtune dhe te diele dhe ditet e festave sipas grafikut te meposhtem.  
Numri total i punonjesve(roje) do te jete 4.7 ( kater presje shtate )

Urgjenca sherbim 24 ore

Public Health Sector

(tre turne)

Nr.	Objekti i Prokurimit	Periudha në muaj	Nr. Rojeve	Nr.Vendroje	Turnet/Vendroje
1.	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, të Drejtorise se Sherbimit Spitalor Sarandë	10.31 muaj (310 dite)	4.7	1	(T1+T2+T3) ditët e punes,te pushimit dhe festat

## TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

## Objekti dhe qellimi i shërbimeve:

*Sherbim me Roje private ne ambientet e Spitalit Sarande , me adrese Rr. ONHEZMI , L.3 , me qellim ruajtjen e qetesise, rendit, sigurise se jetes se personelit gjate orarit zyrtar dhe parandalimin e cdo tentative ose veprimi qe ka per synim vjedhjen ose demtimin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.*

1. Rojet të jenë të pajisur me armë dhe mjete të tjera mbrojtëse, me uniformë të veçantë dhe dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.
2. Të ruajnë me përkushtim objektin që i janë besuar, të ruajnë rendin në to, si dhe të sigurojnë jetën e personelit.

**Detyrat:** Roja ka për detyrë:

- Shoqeria duhet te marre persiper c' demtimin 100% te demeve qe vijne per shkak te moskryerjes si duhet te shërbimit nga punonjesit e shoqerise ( Roje )
  - Të mos lejojë futjen e personave në objekte pa flete-hyrje.
  - Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
  - Për persona që vijnë për probleme pune, duhet të njoftoj më parë kërkuesin dhe me lejen e tij e shoqeron tek personi i kërkuar.
  - Të sigurojë vendparkimin e ndodhur brenda Drejtorise se Sherbimit Spitalor Sarandë, sipas vëndeve të përcaktuara nga institucioni.
  - Para marrjes së shërbimit, kontrollojnë objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe atë të objekteve përkatëse, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
  - Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlikohjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë me shkrim përgjegjësën e rojeve dhe atë të objekteve përkatëse.
  - Në rast zjarri mer masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset.
  - Të kerkojë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brendëshme të objekteve.
- Kur në objekte kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente.
- Roja përdor armën në bazë të legjislacionit në fuqi.
  - Roja i objektit për kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me policinë e rendit.

-Roja për marjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min.para. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjësit.

-Ndalohet futja dhe qendrimi i rojës në ambjentet e brendëshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.

-Roja gjatë kohës së shërbimit duhet të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.

-Rojës, gjatë kohës së shërbimit, i ndalohet të pijë, pije alkoolike, të flejë, të bisedojë me njerëz të jashtëm.

-Roja duhet të zbatojë vetëm urdhërat e përgjegjësit të rojeve dhe drejtorave përkatës.

-Ndalohet kategorikisht marrja e armatimit me vehte, por t'i dorëzohet me proces verbal rojës së rradhës.

-Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit.

c-Grafiku i shërbimit.

d-Inventari i materialeve që ndodhen në objekte.

e-Mjete ndriçimi në rast mungese energjije elektrike.

f-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objekteve përkatës.

g-Skemën e njoftimi në rast sulmi ose zjarri në objekte.

h-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekte.

-Roja për probleme urgjente të shërbimit përdor mjetet e ndërlihdjes së objektit.

-Ndalohet ndërrimi i grafikut të shërbimit pa miratimin e përgjegjësit të rojeve.

**4.Shpërndarja:** Të bëhet sipas turneve të sipërpërmëndura, për të siguruar mbulimin e tyre me shërbimin e rojeve pa ndërprerje gjatë gjithë periudhës nga data e lidhjes së kontratës , ora 00.<sup>oo</sup> deri me 31.12.2017, ora 24 <sup>oo</sup>.